

## AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I SHOQËRISË PERUTNINA PTUJ ALBANIA SHPK

Sot më datë 26 . 04 .2024, palët e mëposhtme:

- **Perutnina Ptuj d.o.o.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Sllovenisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Regjistri i Shoqërive/Biznesit në Slloveni, me numër regjistrimi 5141966000, dhe me seli në adresën Potrčeva cesta 10, 2250 Ptuj, Slloveni (referuar në vijim si “**Perutnina**”), përfaqësuar nga **Enver ŠIŠIĆ dhe Yevheniy DRANOV**,
  - **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri, me numër identifikimi unik K72223031K, dhe seli në adresën Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri (referuar në vijim si “**Balfin**”), përfaqësuar nga **Znj. Edlira Muka**.
- në cilësinë e Ortakëve, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, nëpërmjet këtij dokumenti themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 1

#### Emërtimi

Ky Akt Themelimit dhe Statut (në vijim referuar sëbashku si “**Statuti**”) rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, emërtuar si “**Perutnina Ptuj Albania**” SHPK (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

### Neni 2

#### Forma ligjore

Perutnina Ptuj Albania SHPK themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, veçanërisht sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “**Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare**”, i ndryshuar (referuar në vijim si “**Ligji për shoqëritë tregtare**”), dhe në përputhje me këtë Statut.

### Neni 3

#### Selia

- 3.1** Selia e Shoqërisë është në adresën: “**Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri**”.
- 3.2** Shoqëria nëpërmjet Administratorit të saj mund të çelë dhe/ose mbyllë seli sekondare, degë, dhe/ose zyra përfaqësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.



## Neni 4

### Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare për një kohëzgjatje të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
- 4.2 Shoqëria mund të prishet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe të legjislacionit në fuqi.

## Neni 5

### Objekti i veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria ka si veprimtari tregtare të saj investimin në industrinë e shpendëve nëpërmjet blerjes së shoqërive, biznesit dhe asetëve.
- 5.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për të përmbushur objektin e mësipërm, Shoqëria mund të kryejë:
- i) çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme;
  - ii) çdo veprimtari tregtare, financiare, huaje, barrësimi ose pengu.
- 5.3 Shoqëria, me qëllim investimin në kapital, mund të zotërojë interesa dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose konsorciume etj. të cilat kanë veprimtari të ngjashme ose të lidhura me veprimtaritë e mësipërme.
- 5.4 Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të nevojshme të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

## Neni 6

### Ortakët dhe Kapitali

- 6.1 Ortakët e Shoqërisë janë:
- i) **Perutnina Ptuj d.o.o.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Sllovenisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Regjistri i Shoqërive/Biznesit në Slloveni, me numër regjistrimi 5141966000, dhe me seli në adresën Potrčeva cesta 10, 2250 Ptuj, Sllovenia, zotërues i kuotës Perutnina (sikurse përcaktohet më poshtë); dhe
  - ii) **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri, me numër identifikimi unik K72223031K, dhe seli në adresën Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri, zotërues i kuotës Balfin (sikurse përcaktohet më poshtë).
- 6.2 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 Euro (njëqind euro), nënshkruar dhe shlyer si më poshtë:
- i) Perutnina ka kontribuar në vlerën prej 81 (tetëdhjetë e një) Euro; dhe
  - ii) Balfin ka kontribuar në vlerën prej 19 (nëntëmbëdhjetë) Euro.
- 6.3 Bazuar në kontributet e përcaktuara më sipër në nenin 6.2:



- i) Perutnina zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 81% (tetëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, referuar në vijim si “**Kuota Perutnina**”.
  - ii) Balfin zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 19% (nëntëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, referuar në vijim si “**Kuota Balfin**”.
- 6.4 Pavarësisht sa parashikohet në nenin 6.2 dhe 6.3, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, dividenti i shoqërisë mund të shpërndahet në mënyrë joproporcionale ndërmjet ortakëve.

## Neni 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 7.1 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kapitali themeltar mund të rritet në çdo kohë, kurdo dhe për më shumë se një herë.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë Ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në proporcion me kuotën që mbajnë në kapitalin e Shoqërisë. Nëse ndonjë nga Ortakët heq dorë nga e drejta e nënshkrimit, pjesa e mbetur e tij mund të nënshkruhet nga Ortakët e tjerë.
- 7.3 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën vlerën ALL 100 (njëqind lekë), e cila është vlera minimale e kapitalit të nevojshëm sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 7.4 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë ndikon te Ortakët në përpjesëtim me kuotën që zotërojnë në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

## Neni 8

### Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat mund të transferohen sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe në përputhje me kushtet e afatet e rëna dakord me shkrim nga Ortakët herë pas here.
- 8.2 Vetëm nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Ortakëve, kuotat mund të transferohen lirisht: (i) ndërmjet ortakëve dhe bashkëshortëve dhe/ose fëmijëve të tyre, (ii) ndërmjet ortakëve dhe palëve të lidhura me to. Në çdo rast, kuotat nuk mund të transferohen te persona të cilët kanë sanksione ndërkombëtare, përfshirë sanksione të vendosura nga Kombet e Bashkuara ose autoritetet qeveritare të Shteteve të Bashkuara, Bashkimit European, vendeve anëtare të BE ose Ukrainës. Për më tepër, personi nuk mund të ketë shtetësi ruse apo të jetë shoqëri ruse, qoftë kontroll apo pronësi e drejtpërdrejt ose tërthortë, ka lidhje me një shtetas rus apo person juridik rus.

## Neni 9

### Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 9.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.



9.2 Në Asamblenë e Përgjithshme përfaqësohen të gjithë Ortakët dhe vendimet e tyre të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e themelimit të Ortakëve. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse, *inter alia*, për vendimmarrjet si më poshtë:

- i) Ndryshimi i Statutit;
- ii) Transformimi, ndarja, bashkimi, likuidimi, shpërndarja, ose riorganizimi në çdo formë e saj;
- iii) Pjesëtimi ose anulimi i kuotave të Shoqërisë;
- iv) Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- v) Përcaktimin e politikave tregtare dhe planin strategjik të zhvillimit të Shoqërisë;
- vi) Miratimi i buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim, për aq kohë sa ky ndryshim rezulton në një përqindje prej jo më pak se 5 % e buxhetit vjetor aktual dhe/ose të planit të biznesit;
- vii) Miratimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitur nga Administratori i Shoqërisë;
- viii) Miratimi i shpërndarjes së fitimeve;
- ix) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, audituesve, ekspertëve kontabël, dhe/ose likuidatorëve të Shoqërisë, nëse ka, dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- x) Miratimin e huave ose linjave të kredive për Shoqërinë, dhe rinovimin e huave ose linjave të kredive ekzistuese të Shoqërisë, vetëm nëse huaja ose linja e kredisë ekzistuese, është në vlerën që tejkalon 1,000,000 EUR (një milion euro);
- xi) Vendosja ose dakordësimi për të vendosur barrë, përfshirë por pa përjashtuar kredi, peng ose çdo detyrim tjetër të vendosur mbi asetet e paluajtshme të Shoqërisë;
- xii) Vendosja ose dakordësimi për të vendosur barrë, përfshirë por pa përjashtuar kredi, peng ose çdo detyrim tjetër të vendosur mbi asetet e luajtshme të Shoqërisë në një vlerë që tejkalon 150,000 EUR (një qind e pesëdhjetë mijë euro);
- xiii) Garantimi ose hyrja në marrëveshje të tjera për të siguruar detyrimet e Shoqërisë ndaj palëve të treta;
- xiv) Blerja, shitja ose shkëmbimi i pasurive të paluajtshme në emër të Shoqërisë dhe çdo kontratë tjetër lidhur me krijimin, zgjerimin ose zvogëlimin e pasurive të paluajtshme;
- xv) Blerja ose shkëmbimi i aseteve me vlerë që tejkalon 200,000 EUR (dyqind mijë euro), shitja e aseteve me vlerë që tejkalon 20,000 EUR (njëzet mijë euro) ose shkëmbimin e pajisjeve të prodhimit të Shoqërisë, në masën që ky veprim nuk është pjesë e planit të miratuar të biznesit;
- xvi) Miratimin e krijimit të filialeve, të bashkimit të ndërmarrjeve (*joint venture*) ose sipërmarrjeve që kanë të bëjnë direkt ose indirekt me financime ose investime nga Shoqëria, ose pjesëmarrjen në projektet ekzistuese, në çdo rast, në masën që projekti i ardhshëm nuk është pjesë e planit të miratuar të biznesit;



- xvii) Hyrja në marrëveshje, ndryshimi ose zgjidhja e marrëveshjeve ose marrëdhënieve me ndonjë ortak ose palë të lidhura të ortakut për një vlerë që tejkalon 50,000 EUR (pesëdhjetë mijë euro);
- xviii) Hyrja në marrëveshje, ndryshimi ose zgjidhja e marrëveshjeve ose marrëdhënieve jooperacionale. Marrëveshjet ose marrëdhëniet jooperacionale nuk i përkasin veprimtarisë së përditshme apo veprimtarisë kryesore të Shoqërisë;
- xix) Hyrja në marrëveshje, ndryshimi ose zgjidhja e marrëveshjeve ose marrëdhënieve operationale për një vlerë që tejkalon 100,000 EUR (njëqind mijë euro) për vit ose për kohëzgjatjen e marrëveshjes ose marrëdhënies për aq kohë sa kjo marrëveshje ose marrëdhënie nuk është pjesë e buxhetit të miratuar;
- xx) çështje të tjera të parashikuara nga ligji dhe Statuti.

## **Neni 10**

### **Pjesëmarrja në Asamblesë e Përgjithshme të Ortakëve, thirrja, kuorumi dhe vendimet**

- 10.1** Ortakët marrin pjesë në Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe votojnë në përputhje me të drejtat e tyre sikurse parashikohen në Nenin 6.3 më sipër.
- 10.2** Ortakët kanë të drejtë të përfaqësohen në Asamblesë e Përgjithshme nga një person tjetër i pajisur me prokurë, i cili mund të mos jetë ortak. Në çdo rast, prokura lëshohet vetëm për një Asamble Ortakësh, dhe është e vlefshme vetëm për thirrjen e parë dhe të dytë të së njëjtës agjendë.
- 10.3** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda muajit të 6 (gjashtë) të vitit financiar, me qëllim miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe në çdo kohë kur Administratori e gjykon të arsyeshme, ose kur kërkohet me shkrim nga një ose më shumë ortakë që zotërojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- 10.4** Ortakët njoftohen lidhur me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrje në adresat e tyre të njoftimit. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes së asamblesë dhe i dërgohet secilit ortak jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë mënyrën e pjesëmarrjes në Asamblesë e Përgjithshme të Ortakëve dhe/ose mënyrën e vendimmarrjes. Njoftimi i mbledhjes duhet të përmbajë edhe një datë të dytë në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit në përputhje me dispozitat e këtij Statuti. Nëse njoftimi i mbledhjes dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marrë rregullisht nga ortakët për datën/orën e specifikuar në mesazhin e marrë/dërguar në njoftimin me e-mail.
- 10.5** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mund të mbahet në selinë e shoqërisë ose në ndonjë vendndodhje tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 10.6** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të zhvillohet me video/telekonferencë me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari, dhe t'u

- mundësohet të ndjekin bisedën dhe të marrin pjesë në diskutime. Pas verifikimit të elementëve të mësipërm, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e zhvilluar në vendin ku kryetari i mbledhjes ka qenë i pranishëm.
- 10.7** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse nuk janë respektuar të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj, me kusht që të gjithë ortakët që zotërojnë të gjithë kapitalin e shoqërisë janë të pranishëm dhe të gjithë pranojnë të vazhdojnë me mbledhjen pavarësisht parregullsive të thirrjes së saj.
- 10.8** Në çdo rast, në mungesë të kuorumit, në mbledhje nuk mund të diskutohet rendi i ditës, dhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të rimblidhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë në të njëjtin vend dhe në të njëjtën mënyrë sikurse ishte planifikuar fillimisht.
- 10.9** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve kryesohet nga kryetari i cili emërohet nga kjo e fundit. Në mbledhje kryetari zgjedh dhe emëron një sekretar për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
- 10.10** Vendimet dhe procesverbalet e Mbledhjes së Ortakëve duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruara nga kryetari dhe sekretari. Vendimet duhet të përfshijnë, me kërkesë të Ortakëve, deklaratimet si dhe vrojtimet gjatë mbledhjes.
- 10.11** Në rast se Ortakët ftohen të vendosin nëpërmjet një vendimi qarkullues, kuorumi konsiderohet i arritur bazuar në numrin e Ortakëve që dërgojnë votat e tyre dhe vendimet me shkrim. Administratori ose çdo Ortak i cili kërkon vendimmarrjen duhet të njoftojë secilin Ortak lidhur me vendimin qarkullues, i cili përmban të gjithë informacionin në njoftim/telefonatë sikurse parashikohet në Statut. Procedura e vendimit qarkullues duhet të jetë në përputhje me paragrafët e kësaj dispozite kur është e nevojshme. Çdo Ortak duhet të shprehë opinionin e tij me shkrim lidhur me draft vendimin dhe votën mbi draft vendimin në formën e dërguar nga Administratori, duke shkruar “pro” ose “kundër” ose duke shprehur komentet e tyre në dokument. Nëse Ortakët kanë komente, ato duhet të bëjnë referencë të qartë të draft vendimi. Çdo Ortak duhet t’i dërgojë Administratorit ose Ortakut që ka kërkuar miratimin e vendimit të shkruar, votën e tij/vendimin me shkrim brenda datës së specifikuar në njoftimin e dërguar lidhur me vendimin me shkrim.
- 10.12** Në përputhje me nenin 10.13 më poshtë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme nëse pjesëmarrësit përbëjnë më shumë se pesëdhjetë për qind (50% +) të të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote. Vendimet duhet të merren me shumicën e votave që përbëjnë të paktën pesëdhjetë për qind (50%) të Ortakëve pjesëmarrës në Mbledhje.
- 10.13** Pavarësisht sa parashikohet në Nenin 10.12 më sipër, nëse Ortakët duhet të votojnë dhe vendosin në lidhje me Vendime e Rëndësishme (të përcaktuara në nenin 10.14 më poshtë), Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë më shumë se tetëdhjetë e pesë për qind (85%+) e numrit total

të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote. Në këtë rast, vendimet duhet të merren me votën unanime të Ortakëve pjesëmarrës në Mbledhje (“Shumicë e Cilësuar”).

**10.14** Vendimet e mëposhtme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve (“Vendimet e Rëndësishme”) merren në përputhje me procedurat vendimmarrëse të Shumicës së Cilësuar:

- i) ndryshimi i Statutit;
- ii) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- iii) shpërndarjen e dividendit;
- iv) transformimin, ndarjen, bashkimin, tjetërsimin, likuidimin, prishjen ose riorganizimin e Shoqërisë në çdo formë;
- v) miratimi i buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim lidhur me to për aq kohë sa ndryshimi rezulton të jetë më pak se 5% të buxhetit vjetor fillestar dhe/ose planit të biznesit;
- vi) miratimi i huave ose linjave të kredisë për Shoqërinë dhe rinovimin e çdo huaje ekzistuese ose linjave të kredisë ekzistuese të Shoqërisë, por vetëm për aq kohë sa huaja ekzistuese ose linja e kredisë ekzistuese tejkalon vlerën prej 1,000,000 EUR (një milion euro);
- vii) blerja, shitja ose shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme në emër të Shoqërisë dhe çdo marrëveshje për krijimin, zgjerimin ose zvogëlimin e pasurisë së paluajtshme;
- viii) blerja ose shkëmbimi i aseteve që tejkalojnë vlerën prej 200,000 EUR (dyqind mijë euro), shitja e aseteve që tejkalojnë vlerën 20,000 EUR (njëzet mijë euro) ose shkëmbimi i pajisjeve të prodhimit të Shoqërisë, për aq kohë sa ai veprim nuk është pjesë e planit të miratuar të biznesit;
- ix) miratimi për krijimin e filialeve, bashkimit të ndërmarrjeve (joint venture) apo çdo lloj tjetër sipërmarrje të re që lidhet direkt ose indirekt me financimin ose pjesëmarrjen e Shoqërisë në projekte ekzistuese, në çdo rast, për aq kohë sa ajo nuk është pjesë e planit të miratuar të biznesit;
- x) Hyrja në marrëveshje, ndryshimi ose zgjidhja e marrëveshjeve ose marrëdhënieve me ndonjë ortak ose palë të lidhura të ortakut për një vlerë që tejkalon 100,000 EUR (njëqind mijë euro);
- xi) Hyrja, ndryshimi ose zgjidhja e marrëveshjeve ose marrëdhënieve jooperacionale për një vlerë që tejkalon 500,000 EUR (pesëqind mijë euro) për vit ose për kohëzgjatjen e marrëveshjes ose marrëdhënies. Marrëveshjet ose marrëdhëniet jooperacionale nuk i përkasin veprimtarisë së përditshme të shoqërisë apo veprimtarisë thelbësor operacionale të saj;
- xii) Nisja ose zgjidhja e një procesi gjyqësor/arbitrazhi për një vlerë prej më shumë se 1.000.000 EUR (një milion) dhe 500,000 EUR (pesëqind mijë euro), nëse lidhet me autoritete tatimore dhe autoritete të tjera publike).

## Neni 11

### Administratori

- 11.1** Shoqëria administrohet nga një administrator i cili përfaqëson Shoqërinë. Administratori i parë i Shoqërisë është:
- *Znj. Saviola Shahollari, shtetase shqiptare, lindur më 10.10.1980, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 034252394, identifikuar me numër personal identiteti I06010044P.*
- 11.2** Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe mund të shkarkohet në çdo kohë me vendim të këtij të fundit. Perutnina gëzon të drejtën ekskluzive të emërimit të Administratorit, i cili miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 11.3** Administratori është individ, pa kufizime shtetësie. Afati i emërimit të Administratorit vendoset në momentin e emërimit të tij, por në çdo rast, nuk mund të tejkalojë 3 (tre) vite. Pavarësisht kufizimit të mësipërm, afati i emërimit mund të rinovohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

## Neni 12

### Kompetencat e Administratorit

- 12.1** Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te palë të treta, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit të zbatueshëm.
- 12.2** Kompetencat e Administratorit lidhur me administrimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë përshin por nuk kufizohet në sa më poshtë:
- i) zbatimin e politikave biznesore të Shoqërisë dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - ii) të sigurojë që Shoqëria zbaton ligjin dhe standardet kontabël;
  - iii) të kryejë të gjitha veprimet lidhur me administrimin e veprimtarisë biznesore të Shoqërisë;
  - iv) të sigurojë mbajtjen e rregullt të dokumentacionit financiar dhe kontabël të Shoqërisë;
  - v) përfaqësimi i Shoqërisë te palë të treta;
  - vi) të kryejë të gjitha regjistrimet e detyrueshme dhe publikimet lidhur me Shoqërinë sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
  - vii) kryerja e të gjitha detyrave sikurse përcaktohet nga ligji dhe ky Statut.
- 12.3** Administratori kryen të gjitha kompetencat dhe veprimet përveç atyre të cilat: a) sipas ligjit, marrëveshjes dhe Statutit janë kompetenca të Asamblesë së Ortakëve, b) janë kufizuar nga ky Statut dhe legjislacioni i zbatueshëm, c) nuk janë lidhur drejtpërdrejt me planin e miratuar të biznesit të Shoqërisë, dhe d) nuk janë të nevojshme për kryerjen e biznesit të përditshëm të Shoqërisë.



- 12.4 Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij ose një pjesë të tyre personave të tjerë, sipas kufizimeve të mësipërme.
- 12.5 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të përcaktojë me vendim, kufizime shtesë të kompetencave, objekt i kompetencave të Administratorit.
- 12.6 Administratori duhet të krijojë dhe mbajë një cikël të rregullt raportimi në intervale tremujore, duke siguruar se raportet i dërgohen Ortakëve jo më vonë se 30 ditë pune pas përfundimit të secilës periudhë raportimi.
- 12.7 Informacioni i cili i duhet njoftuar Ortakëve përfshin por nuk kufizohet në:
- i) Plani vjetor i biznesit, i cili duhet të përfshijë fitimin e parashikuar dhe llogarinë e humbjes i cili përfshin buxhetin operativ me kërkesat e shpenzimeve kapitale të parashikuara, bilancin e parashikuar dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare (cashflow), rishikimi i biznesit të projektuar dhe përmbledhja e objektivave biznesore;
  - ii) Deklaratat mujore të fitimit dhe humbjes krahasuar me planin vjetor të biznesit, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare (cashflow), parashikimi vjetor i përditësuar i fitimit dhe humbjes, realizimi i capex kundrejt buxhetit dhe treguesit kryesor të performancës (KPI) për biznesin, lidhur me Shoqërinë brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve pas përfundimit të muajit përkatës;
  - iii) Kopje të llogarive të audituara të Shoqërisë lidhur me secilin vit financiar menjëherë sapo ato të jenë të disponueshme dhe në çdo rast jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e secilit vit financiar;
  - iv) Çdo informacion të nevojshëm për të cilin ata gëzojnë të drejtën të kenë dijeni sipas ligjit të zbatueshëm.
- 12.8 Secili prej Ortakëve mund të kërkojë raporte ad-hoc reports ose informacion nga Administratori brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe brenda mundësive të Administratorit për të ofruar informacionin e kërkuar.

### **Neni 13**

#### **Ekspert kontabël i autorizuar**

Nëse kërkohet nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të miratuar.

### **Neni 14**

#### **Viti financiar dhe pasqyrat financiare**

- 14.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 14.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- 14.3 Pasqyrat vjetore financiare, inventari dhe raporti i ecurisë i hartuar nga Administratori dhe eksperti kontabël, nëse ka, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare.



## Neni 15

### Shpërndarja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 15.1 Shoqëria shpërndahet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve marrë me kuorumin e nevojshëm të përcaktuar në këtë Statut.
- 15.2 Procedura e likuidimit kryhet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 15.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me ligjin në fuqi.
- 15.4 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për qëllime të likuidimit deri në përfundimin e procedurës. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj procedure, emri i Shoqërisë shoqërohet me togfjalëshin “*në likuidim*”.

## Neni 16

### Dispozitat ligjore dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ky Statut përpilohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe interpretohet sipas dispozitave përkatëse të tij. Zbatimi i tij do të kryhet sipas legjislacionit shqiptar. Për çka nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij Statuti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

*Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën angleze dhe 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje, versioni në gjuhën angleze do të prevalojë.*

### ORTAKËT E PERUTNINA PTUJ ALBANIA SHPK

**Perutnina Ptuj D.o.o**

Nga: Enver SISIC

Pozicion: CEO

Nga: Yevheniy DRANOV

Pozicion: CFO

**Balfin – Balkan Finance Investment Group  
SHPK**

Nga: Edlira Muka

Pozicion: Administrator



**ARTICLES OF ASSOCIATION AND BYLAWS OF  
PERUTNINA PTUJ ALBANIA SHPK**

This day, on 26 . 04 .2024, the undersigned:

- *Perutnina Ptuj d.o.o., a limited liability company, established and organized in accordance with the laws of Slovenia, registered with the Commercial Register held by the Business/Companies Register in Slovenia, with registration no. 5141966000, and legal seat at the address Potrčeva cesta 10, 2250 Ptuj, Slovenia (hereinafter referred to as “Perutnina”), duly represented by Enver ŠIŠIĆ and Yevheniy DRANOV.*
- *Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, a limited liability company, established and organized in accordance with the laws of Albania, registered with the Commercial Register held by the National Centre of Business in Albania, with registration no. K72223031K, and legal seat at the address Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri (hereinafter referred to as “Balfin”), duly represented by Mrs. Edlira Muka.*

*in the quality of shareholders, with free and full will, through this document establish a limited liability company in accordance with the legislation in force of the Republic of Albania and with the present act.*

**Article 1**

**Denomination**

This Articles of Association and Bylaws document (hereinafter referred to as the “Bylaws”) regulates the organization and functioning of the limited liability company, denominated as “Perutnina Ptuj Albania” SHPK (hereinafter referred to as the “Company”).

**Article 2**

**Legal form**

Perutnina Ptuj Albania SHPK is a limited liability company, established and organized in accordance with Albanian legislation and in particular with the provisions of Law no. 9901, dated 14.04.2008 “On Entrepreneurs and Commercial Companies”, as amended (hereinafter referred to as the “Company Law”), and in accordance with these Bylaws.

**Article 3**

**Registered Office**

- 3.1** The legal seat of the Company shall be at the address: “Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri”.
- 3.2** The Company through its Administrator may establish and/or close subsidiaries, branches, agencies, and/or representation offices, either within or outside of the territory of the Republic of Albania.



## Article 4

### Duration

